NENI 24 KUORUMI 1. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë <u> shumicë të kualifikuar</u>, sipas nenit 25 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve nenit 26 të këtij statuti. 2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë një <u> shumicë të zakonshme</u>, sipas nenit 25 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve nenit 26 të këtij statuti. 3. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 dhe/ose pikën 2 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. 4. Derisa shoqëria të jetë me një ortak këto vendime merren nga ortaku i vetëm sipas dispozitave të këtij statuti, si dhe sipas kërkesave ligjore në fuqi.	ARTICLE 24 CUORUM 1. Where the General Meeting of Members has to decide on matters requiring a <u>qualified majority</u>, pursuant to Article 25 of this Statute, it may make valid decisions only if the partners owning more than half of the total number of votes are personally present, vote by letter, or electronically, according to the provisions of Article 26 of this Statute. 2. Where the General Assembly of the Members has to decide on matters which require <u>an ordinary majority</u> in accordance with Article 25 of this Statute, it may make valid decisions only if the eligible voting partners are present, more than 30 percent of the quotes are personally present, vote by letter, or electronic means, according to the provisions of Article 26 of this Statute. 3. If the General Assembly of Partners cannot meet due to the absence of the quorum mentioned in point 1 and/or point 2 of this article, the General Assembly of Partners shall convene again no later than 30 days, with the same order day. 4. Until companies are with one partner, these decisions are taken by the sole partner through the dispositions of this statute and according to the legal requirements in force.
NENI 25 MARRJA E VENDIMEVE	ARTICLE 25 TAKING DECISIONS

12

Sabamfame

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) për çështjet e përcaktuara në nenin 19, shkronja "b", shkronja "i", shkronja "l", si dhe shkronja "m". 2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar ose në këtë statut për çështjet e tjera të ndryshme nga ato të caktuara në pikën 1 të këtij neni e të renditura në nenin 19 të këtij statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. 3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës. 4. Përcaktimet e pikës 1 deri tek pika 3 e këtij neni do të zbatohen kur shoqëria të bëhet me më shumë se një ortak dhe deriatëhere vendimet merren nga ortaku i vetëm.	1. The General Assembly of the Partners shall decide by three-fourths of the votes of the participating partners (the most qualified one) for the matters referred to in Article 19, letter "b", letter "i", letter "l", and letter "m". 2. Except as otherwise provided in Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Traders and Business Companies" as amended or in this Statute, for matters other than those specified in paragraph 1 of this Article and contained in Article 19 of this Statute. The General Assembly of Partners shall decide with the majority of the votes of the participating partners. 3. Except as otherwise provided in this law, the validity of decisions, which impose additional obligations on partners, or decisions restricting their rights provided for in this law or the statute, is conditional on the approval of the respective partner. 4. The definitions of point 1 to point 3 of this article shall apply when the company is to be made with more than one partner, so decisions are made by the sole partner.
NENI 26 E DREJTA E VOTËS Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij. Lejohet pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: • transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; • komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehin për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; • mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: • vlerësimin e veprimtarisë së tij; • shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; • ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; • dhënien ose jo të përfitimeve të reja.	ARTICLE 26 THE RIGHT TO VOTE Each quote entitles one vote. Each partner has the right to vote in proportion to the nominal value of his quota. It is expected to attend the meeting of the General Assembly of Partners with various means of communication, including electronic means, provided that the partners are guaranteed. Electronic means include, but are not limited to: • transmission of general assembly meetings in real time, • real-time mutual communication, which enables partners to express general assembly meeting from another location; • mechanisms that enable the voting process before or during the general assembly meeting, without the need to appoint an authorized representative to participate physically at the meeting. The partner cannot practice the right to vote if the General Assembly makes a decision on • assessment of his activity, • termination of any obligation under his responsibility, • filing a lawsuit against him by the company, • giving or not of new benefits. When the partner is represented by an authorized




Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortak, të cilin përfaqëson. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar	representative, the authorized person is deemed to be at the same conflict of interest, as well as the partner, whom he represents. Except as otherwise provided in the statute, each partner has voting rights proportional to the nominal value of his quota. The co-owners of a quota utilize their voting rights jointly, pursuant to Article 72 of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On traders and commercial companies" as amended.
NENI 27 PROCESVERBALI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal me numër dhe datë dhe/ose në format elektronik, kur shoqëria të bëhet me më shumë se një ortak. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.	ARTICLE 27 RECORD OF THE GENERAL ASSEMBLY All decisions of the General Assembly must be recorded in the record with the number and date and/or in electronic format when the company is made with more than one partner. The administrator is responsible for maintaining copies of the minutes of the General Assembly meetings. The records must contain the date of the meeting place, the agenda, the name of the chairman and the record holder, the results of the voting. The records are also attached to the list of participants, as well as the act of calling the General Assembly. The record of the meeting is signed by the chairman and the record holder.
NENI 28 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË Shoqëria "BALKAN POWER INTERNATIONAL" Sh.p.k. administrohet nga administratori: Z. Vladimir Mulaj, i biri i Adulla dhe Drita, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 20.09.1967, i identifikuar sipas letërnjoftimit elektronik me Nr. Personal: G70920225W madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, shtetas Shqiptar. Ky emërim në këtë post bëhet i plotë, me dëshirë dhe me vullnet të lirë, nën përgjësën e ortakëve themelues dhe pa asnjë vërejtje apo pretendim nga ortakët themelues. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "BALKAN POWER INTERNATIONAL" Sh.p.k. dhe regjistrohet si i tillë pranë QKB. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.	ARTICLE 28 ADMINISTRATION OF COMPANY 1. The company "BALKAN POWER INTERNATIONAL" LLC. administered by the administrator: Mr. Vladimir Mulaj, son of Adulla and Drita, born in Tropojë and resident in Tirana, birthday 20.09.1967, identified through electronic ID with Personal No: G70920225W, Major and full legal capacity to act, with civilian status, Albanian citizen, who understand very well the English language. This appointment in this post becomes complete, willing and willingly, under the responsibility of the founding partners and without any objection or claim from the founding partners. The company may have more than one administrator when it is decided by the General Assembly of Partners of "BALKAN POWER INTERNATIONAL" LLC, and is registered as such with the ICC. The compensation of the administrator should be appropriate and in accordance with the duties of the administrators and the financial standing of the company. If the company is in financial difficulty, the single partner or the General Assembly of Partners may decide to reduce the compensation of the directors to the appropriate

Salamfame

Shoqëria "BALKAN POWER INTERNATIONAL" Sh.p.k. dhe pas krijimit të saj dhe fitimit të personalitetit juridike shpërblim administratorin e saj të zgjedhur me një pagë mujore bruto prej 40.000 (dyzete mijë) lek. Kontrata e Punës së Administratorit rregullohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi për këtë qëllim.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur.

Administratori emërohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Kontrata e punës së administratorit duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me këtë akt themelimi dhe/ose statut:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqëson shoqërinë tregtare
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejn regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryerjen e detyrave të tjera që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- Të informojë Asamblesën e Përgjithshme mbi ndryshimet ligjore që kanë lidhje me aktivitetin tregtar të shoqërisë si dhe me aktet bazë të shoqërisë ti till si por jo vetëm statuti si dhe akti i themelimit.

extent.

"BALKAN POWER INTERNATIONAL" LLC and after its creation and gaining legal personality reward its elected administrator with a monthly salary of 40.000 (dyzete mijë) lek. The Work Contract of the Administrator is governed by the Albanian legislation in force for this purpose.

The General Assembly of Partners may dismiss the administrator at any time by an ordinary majority.

The term of appointment, which is set out in the statute, may not exceed 5 years, with the right of renewal, except for resignation or abortion.

The administrator is appointed for a period of five (5) years with the right to re-election. The contract of the administrator's work must be approved by the General Assembly of Partners.

The Administrator has rights and obligations as follows quoted in accordance with Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On traders and commercial companies" and with this act of establishment and/or statute:

- performs all actions of the administration of the business activity of the company, by applying the trade policies established by the general assembly
- Represents the business organization;
- takes care of accurate and regular keeping of the company's documents and books;
- prepares and signs the annual balance sheet, the consolidated balance sheet, and the performance report and, together with the proposals for the distribution of profits, submits these documents to the General Assembly for approval;
- creates a timely warning system for the circumstances that threaten the progress of the activity and the existence of the company;
- carries out registrations and sends the compulsory data of the company as provided for in the Law on the National Registration Center;
- reports to the general assembly on the implementation of trade policies and the implementation of special actions of particular importance for the activity of the business organization;
- performing other duties assigned by the General Assembly of Partners.
- Informs the General Assembly of the legal changes related to the business activity of the company and the basic acts of the company as well as but not only the statute and the act of establishment.
- To propose improvements and/or adjustments to the Albanian legislation in force of the founding act and

j) Të propozojë përmirësime dhe/ose përshtatje me legjislacionin shqiptarë në fuqi të aktit të themelimit si dhe të statutit të shoqërisë. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundërshtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.	the statute of the company. In the performance of duties, the administrator shall be liable to the company for any act or omission which is reasonably related to the purposes of the company, except where, on the basis of investigation and evaluation of the relevant information, the act or omission is performed in good faith. The administrator is liable to the company or to third parties for violations of the law as well as for violations of the lawsuit or for faults committed during his administration. The administrator may give up at any time from his duty, by written notice addressed to the General Meeting of Partners. The resigning administrator, taking into account the circumstances of the company's activity, is also required to call the General Assembly of Partners for the appointment of the new administrator before the date on which the resignation takes effect. If the General Assembly of Partners does not decide on the appointment of the new administrator on the date set forth in the call made by the resigned administrator, the administrator shall notify in writing the resignation to the National Registration Center together with a copy of the convocation of the Assembly meeting and the National Registration Center records the removal of the administrator according to the procedures of law no. 9723, dated 03.05.2007, "On the National Registration Center", as amended. The administrator's resignation does not violate the lawsuits of the company for violating the loyalty obligation that the administrator has to it under this law. The appointment of a new administrator shall enter into force on the date determined by the act of appointment, to third parties according to the provisions of Article 12 of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On traders and commercial companies" as amended.
NENI 29 PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundërshtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Administratori/ët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i	ARTICLE 29 REPRESENTATION OF THE COMPANY Limitations on the representation fees of the administrator are subject to third parties, in accordance with the provisions of Article 12 of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Traders and Traders" as amended. Administrators, jointly representing the business organization, may authorize some of them to perform certain actions or to perform certain categories of actions. Legal representation of the company (either directly or delegated by authorization) is valid for any judicial or

deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: • numrin unik të identifikimit; • formën ligjore të shoqërisë; • vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; • të dhëna nëse shoqëria është në likuidim. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.	extrajudicial act. Actions performed by the legal representative of the company (directly or delegated by authorization) are compulsory for the company even if these exceed its scope unless these actions go beyond the representation fees provided by law or allow to be given to the representatives. These actions are not compulsory for the company if the company proves that the third party knew that the act exceeds its object, or on the basis of clear circumstances, it may not have been aware of it. Publication by amending the statute does not constitute sufficient evidence for the knowledge of third parties if this change has been made public in a way other than those provided by the law on the National Registration Center. Announcements addressed to each of the administrators are valid and compulsory for the company. Entitlements of the administrators' representation and any changes to them are notified for registration with the National Registration Center. All records, order forms or any other correspondence document issued by the company, branches or representative offices, through the use of paper or electronic means, addressed to third parties, shall contain the following information: • unique identification number; • the legal form of the company; • the address of the registered headquarters and its head office; • whether the company is in liquidation; If the company has a website, this information should be reflected there.
NENI 30 DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 28 dhe 29 të këtij statuti, administratori/ët detyrohet/n: • të kryejnë detyrat të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; • të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; • të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;	ARTICLE 30 OBLIGATION OF LOYALTY AND RESPONSIBILITY 1. Except as provided in the general provisions of the loyalty obligation under Articles 28 and 29 of this Statute, the Administrator shall: • perform the duties set forth in the law or statute in good faith and in the best interests of the company as a whole, paying particular attention to the impact of the activity of the company on the environment; • use powers that are recognized in law or statute only for the achievement of the goals set forth in these provisions; • to assess accountable issues for which a decision is made;

17

- të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
- të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori/ët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori/ët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme: u kthejnë ortakëve kontributet u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndajnë aktivet shoqërisë; lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; japin kredi.

Asambleja e Përgjithshme dhe sipas përcaktimve ligjore dhe/ose sipas këtij statuti mund të ngrejë padi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe/ose gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorit si pasojë e shkeljeve të rënda të ligjit dhe/ose dispozitave të këtij statuti dhe/ose padi të tjera që parashikon ligji në fuqi. Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë dhe/ose kreditorët e shoqërisë të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrim në një vlerë jo më të vogël se 5 % e kapitalit të shoqërisë, mund të kërkojnë Asamblesë së Shoqërisë ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorit, nëse kjo kërkesë nuk procedohet nga ky organ i shoqërisë brenda 60 ditëve nga njoftimi atëherë kjo kërkesë konsiderohet e rrëzuar. Në rast refuzimi të kërkesës dhe brenda 30 ditëve ortakët apo kreditorët e shoqërisë

- to prevent and avoid cases of conflict, present or potential, of personal interests with those of company;
- to guarantee the approval of agreements under the provisions of paragraph 3 of Article 13 of this Law;
- to execute their duties with professionalism and necessary care.

In the performance of their duties, the administrator shall be liable to the company for any act or omission which is reasonably related to the purposes of the company, except where, on the basis of the investigation and assessment of the relevant information, action or omission was committed in good faith.

If the administrator/s acts in violation of duties and violates professional standards, according to points 1 and 2 of this Article, they are obliged to compensate the company for damages arising from the commission of the violation and to pass any personal profit that they or the persons associated with them have conducted from these irregular actions.

Administrators have the burden to evidence the performance of their duties on a regular basis and according to the required standards.

When the violation is committed by more than one administrator, they respond to the company in a solidarity manner.

In particular, but not limited to, administrators are obliged to reimburse the company for damages incurred if, in violation of the provisions of this law, perform the following actions: reimburse partners, pay partners interest or dividends, distribute the assets to the company, allow the company to continue trading, when, on the basis of the financial position, it should be foreseen that the company would not have the solvency to settle liabilities, give credit.

The General Assembly may, in accordance with legal and / or statutory provisions, file a lawsuit before the Tirana District Court and / or the competent court for annulment of decisions of the Administrator as a result of serious violations of the law and / or provisions of this statutes and / or other lawsuits foreseen by the applicable law.

Partners representing at least 5% of the total votes in the company's association and / or the creditors of the company who claim that the company has a liability to them at a value not less than 5% of the company's capital may ask the Company's Assembly to file a lawsuit for the repeal of the administrator's decisions, if this request is not filed by this body within 60 days of the notification then this claim is considered to be overthrown. In the event of a

mund ta ngrenë këtë padi drejtë për drejtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose në çdo gjykatë kompetente.	refusal of the request and within 30 days, the partners or creditors of the company may file this claim fairly in the Tirana District Court or in any court of competent jurisdiction.
KREU IV VITI FINANICAR DHE EKSPERTI NENI 31 VITI USHTRIMOR, LLOGARI VJETORE Cdo vit ushtrimor fillon në datën 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor. Llogarite vjetore, inventari dhe të dhënat mbi lëvizjet financiare të vitit, raportet speciale të ndërtuara nga administrator dhe ekspert kontabël, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Miratimi i dokumentave mbi aktivitetin vjetor kryhen brenda një afati 6-mujore nga data e mbylljes së vitit ushtrimor. Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidencës së të ardhurave Asambleja e Përgjithshme vendos pjesën që ju takon ortakëve në formën e dividend në të ardhura. Të ardhurat që ndahen mes ortakëve në bazë të pjesëve në kapitalin themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit ushtrimor.	CHAPTER IV FINANCIAL YEAR AND EXPERT ARTICLE 31 EXECUTIVE SUMMARY, ANNUAL ACCOUNT Each operation year begins on January 1 and ends on December 31. Annual accounts, inventories, and data on financial movements of the year, special reports prepared by the administrator and accounting expert are approved by the General Assembly. The approval of documents on the annual activity is carried out within a 6-month period from the closing date of the operation year. After the approval of annual accounts and income records, the General Assembly decides the share that which belongs to the partners in the form of income dividends. The income that is allocated among the partners based on the shares in the charter capital, consists of the profit of the operation year.
NENI 32 EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR Në rast nevojë ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga eksperti kontabël i autorizuar dhe zgjedhur sipas ligjit në fuqi dhe statutit të kësaj shoqërie. Eksperti kontabël emërohet çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabël mund të shkarkohet më përpara se afati i emerimit të tij, siç parashikohet në pikën dy të këtij neni nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabel është i detyruar të zbatojë dispozitat ligjore dhe/ose rregulloret në fuqi.	ARTICLE 32 AUTHORIZED ACCOUNT STATEMENT In case of need or if required by law, the control of the company is carried out by an authorized auditor and selected according to the law in force and the charter of this company. The accounting expert is appointed annually by the General Assembly of the company. The accounting expert may be discharged before the term of his appointment, as provided for in point two of this article by the General Assembly of the company. The accounting expert is obliged to apply the applicable legal provisions and/or regulations.
KREU V PRISHJA, LIKUIDIMI DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË NENI 33 SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË 1. Shoqëria prishet: • kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar; • me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; • në rast se objekti bëhet i pareali-zueshem për	CHAPTER V DISSOLUTION, LIQUIDATION, AND REORGANIZATION OF THE COMPANY ARTICLE 33 THE REASONS OF COMPANY DISSOLUTION 1. Company dissolution: • When the time period for which it is established ends; • upon termination of bankruptcy proceedings or in case of insufficient assets to cover the costs of bankruptcy proceedings; • if the object becomes unavailable due to

19

shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare; • në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" i ndryshuar; • në raste të tjera, të parashikuara me ligj; • për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. 2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo me shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "e" dhe "f", të pikës 1 të këtij neni, vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e cilësuar përcaktuar në këtë statut. 3. Në rast mosveprimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara pikën 2 të këtij neni, çdo person i interesuar mund në çdo kohë t'i drejtohet gjykatës kompetente për të konstatuar prishjen e shoqërisë. 4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundur të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. 5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rezimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit. 6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. 7. Administratori/ët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për	continued malfunction of the organs of the company or for other reasons that render absolutely impossible the continuation of the commercial activity; • in the cases of the invalidity of the company's establishment provided by Article 3/1 of the Law "On Business Organizations", as amended; • in other cases, provided by law; • for any other reason set by the General Assembly of Partners. 2. The dissolution of a company as a consequence of one or more of the causes specified in letters "a", "c", "d", "e" and "f" of paragraph 1 of this article shall be decided by the Assembly General of the Members with the qualified majority laid down in this Statute. 3. In the event of failure of the General Assembly of the Partners to establish the dissolution, for any of the reasons set forth in paragraph 2 of this Article, any interested person may at any time turn to the competent court to ascertain the dissolution of the company. 4. Regardless of the foregoing provisions, the existence of one or more of the causes provided for in paragraph 2 of this Article shall not result in the dissolution of the company and the opening of liquidation proceedings if, prior to the final court decision, mentioned in point 3 of this article, the cause of the dissolution is corrected, if it is possible to be corrected, and this correction is published by the company in the commercial register, according to the provisions of law no. 9723, dated 03.05.2007, "On the National Registration Center", as amended. 5. The dissolution of the company, as a result of the reasons set out in point (b) of paragraph 1 of this Article, is decided by the competent court for bankruptcy proceedings, when, at the conclusion of these proceedings, all assets of the company are liquidated; the collective settlement of liabilities to creditors or when the competent court for bankruptcy proceedings declines the request for opening a bankruptcy procedure due to the inadequacy of the company's assets to cover the costs of bankruptcy proceedings. 6. The dissolution of the company as a result of the reasons provided in letter "c" of point 1 of this article shall be decided by the competent court according to the provisions of article 3/1 of the law no. 9901/2008 "On entrepreneurs and commercial companies" as amended. 7. The Administrator/s register/s the dissolution of the company at the National Registration Center in accordance with Article 43 of Law no. 9723, dated 3.5.2007 "On the National Registration Center". If the
---	--

20
Salem Kama

Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykatë, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.	dissolution of the company is done by a court decision, the court, in accordance with Article 45 of Law No. 9713, dated 3.5.2007 "On the National Registration Center", notifies the decision to the National Registration Center for registration.
NENI 34 LIKUJDIMI DHE FALIMENTIMI Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe sipas dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Falimentimi i shoqërisë bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij statuti, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjit Nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.	ARTICLE 34 LIQUIDATION AND BANKRUPTCY The liquidation of the company is done according to the definitions of this statute and according to the provisions of law no. 9901, dated 14.04.2008 "On traders and commercial companies" as amended. The bankruptcy of the company is done in accordance with the provisions of this statute, Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Traders and Companies" as amended, Law no. 8901, dated 23.05.2002 "On Bankruptcy" as amended, as well as by-laws in force for this purpose. Except where a bankruptcy procedure is initiated, the dissolution of the limited liability company results in the opening of liquidation proceedings in the state of solvency, according to Articles 190 to 205 of Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On traders and commercial companies" as amended.
NENI 35 RIORGANIZIMI I SHOQËRISË Riorganizimi i shoqërisë mund të kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me përcaktimet e këtij statuti, si dhe me dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim.	ARTICLE 35 REORGANIZATION OF THE COMPANY Reorganization of the company can only be carried out by a decision of the General Assembly and in accordance with the provisions of this Statute and the legal provisions in force for this purpose.
NENI 36 LIGJI I APLIKUESHËM Palët caktojnë se për këtë qëllim midis ortakëve dhe për shoqërinë, si dhe për marrëdhëniet e saj me palë të treta pas fitimit të personalitetit juridik do të zbatohet vetëm legjislacioni Shqiptar në fuqi në rast se Ligjit 10428, datë 02.06.2011 "Për të drejtën ndërkombëtare Private" apo marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nuk parashikojnë ndryshe në mënyrë detyruese dhe urdhëruese, në të kundërt legjislacioni shqiptar zgjidhet dhe do të aplikohet.	ARTICLE 36 APPLICABLE LAW The Parties shall determine for this purpose between the partners and the society as well as for its relations with third parties upon the acquisition of the legal personality only the applicable Albanian legislation shall apply in the case of Law 10428, dated 02.06.2011 "On international private law" and agreements ratified by law does not prescribe otherwise compulsory and obligatory, otherwise the Albanian legislation is chosen and will be applied.
NENI 37 MOSMARRËVESHJET Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë kohës së likuidimit mes ortakëve, mes shoqërive dhe ortakëve fillimisht duhet të diskutohen për gjetjen e zgjidhjeve me mirëkuptim. Për	ARTICLE 37 DISPUTES All disagreements that may arise during the company's existence or during the time of liquidation between partners, companies, and partners should first be discussed to find solutions with good understanding. For a

Salom Farnat

zgjidhjen me mirëkuptim palët mund të hartojnë një akt-marrëveshje midis tyre. Palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund ti drejtohen edhe 'Ndërmjetësve Ligjorë' të licencuar në përputhje me ligjin në fuqi. Në rast se palët nuk gjejnë zgjidhje për mosmarrëveshjen e tyre sipas pikave të mësipërme atëherë ato mund ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Statuti i shoqërisë "BALKAN POWER INTERNATIONAL" Sh.p.k u përkthye nga gjuha Shqipe në gjuhën Angleze me të njëjtën përmbajtje dhe pa asnjë ndryshim apo shtesë nga ajo në gjuhën Shqipe.

thoughtful resolution, the parties can draft an agreement between them. Dispute settlement parties may also refer to 'Legal Intermediaries' licensed in accordance with applicable law. If the parties do not find a solution to their dispute under the above points then they may address the Tirana Judicial District Court for settlement of disputes.


The statute of the company "BALKAN POWER INTERNATIONAL" LLC is translated by Albanian language in English language with the same content and without any change or addition to that in Albanian.

**ORTAKËT E SHOQËRISË
"BALKAN POWER INTERNATIONAL" SH.P.K.**

Z. VLADIMIR MULAJ (1 kuotë – 50%)


NËNSHKRIMI

Z. SALEEM PARVAZ (1 kuotë – 50%)


NËNSHKRIMI

ADMINISTRATORI

Z. VLADIMIR MULAJ



NËNSHKRIMI

**PARTNERS OF THE COMPANY
"BALKAN POWER INTERNATIONAL" LLC**

Mr. VLADIMIR MULAJ (1 share – 50%)


SIGNATURE

Mr. SALEEM PARVAZ (1 share – 50%)


SIGNATURE

ADMINISTRATOR

Mr. VLADIMIR MULAJ


SIGNATURE